

Ymer Fejzullahu
Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Mesut Serhat Dinc
Kryeshf Ekzekutiv
KESCO sh.a.

Datë: 22.01.2024


Lënda: Aplikimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2024

I nderuar zt. Fejzullahu,


Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) ka përgatitur Aplikimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregullën për Përcaktimin e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregullën për të Hyrat e FSHU-së).

KESCO mbetet i përkushtuar për bashkëpunim me qëllim që të arrihen konkluzione të përbashkëta të cilat janë në interes të të gjithë pjesëmarrësve në sektorin e energjisë.

Me respekt,



Mesut Serhat Dinc
Kryeshf Ekzekutiv, KESCO sh.a.



	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 1 prej 10
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0


**APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE NË VITIN 2024 PËR
FURNIZUESIN ME SHËRBIM UNIVERSAL**

Janar, 2024

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 2 prej 10
		Versioni	1.0

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Bilanci i energjisë elektrik	3
3. Kostot e blerjes se energjisë me shumicë	4
4. Kostot me pakicë	6
5. Kostot e bartshme	8
6. Përshtatjet dhe Faktori korrigjues i të hyrave	9
7. Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2024	9

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 3 prej 10
		Versioni	1.0

1. Hyrje

Në përputhje me Shtojcën 3 të Rregullës për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU) dhe shkresës zyrtare të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të datës 12 dhjetor 2023, KESCO i ngarkuar me Obligim shërbimit publik për ofrimin e Furnizimit me energji elektrike si Shërbim Universal ka përgatitur Aplikimin për të hyrat e lejuara maksimale (MAR) për vitin 2024.

Në këtë Aplikim janë prezantuar të dhënat energjetike dhe financiare për blerjet e energjisë nga prodhimi vendor dhe importi, përkatësisht kostot e blerjes me shumicë, kostot me pakice, kostot e bartshme dhe përshtatjet për vitet e mëparshme, ndërsa gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale, janë përdorur vlerat e parametrave sipas vendimit të ZRRE –së nr.V_1476_2022 të datës 14 janar 2022.

Duke qenë se procesi tarifor është interaktiv ndërmjet ZRRE-së dhe të licencuarve të tjerë, ky aplikim mund të përshtatet tutje me qëllim të reflektimit të kostove që janë të ndërlidhura me të licencuarit e tjerë.


Kapitujt vijues japin shpjegimet dhe arsyetimet e nevojshme për të gjitha kostot e kërkuara, të cilat janë të domosdoshme për operimin e duhur të Furnizuesit me Shërbim Universal.

2. Bilanci i energjisë elektrik

Furnizuesi me Shërbim Universal çdo vit parashikon shitjet për konsumatorët e tij për vitin e ardhshëm, duke përdorur informatat historike dhe komponentët e tjerë që ndikojnë në shitjet, siç janë kushtet atmosferike dhe rritja ekonomike (përfshirja e konsumatorëve të rinj, indekset e blerjes së energjisë, GDP, etj).

Sipas draft bilancit të energjisë elektrike për vitin 2024, shitjet e parashikuara për FSHU-në për vitin 2024 janë 4,998 GWh, siç janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Niveli i tensionit	GWh
Konsumatorë e kyçur në nivel të tensionit 35 kV	57
Konsumatorë e kyçur në nivel të tensionit 10 kV	485
Konsumatorët komercial 0.4 kV	461
Konsumatorët komercial 0.4 kV / II	773
Konsumatorët e amvisërisë	3,183
Ndriçimi Publik	39
Total konsumi në nivel të shpërndarjes	4,998

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 4 prej 10
		Versioni	1.0

Blerjet e energjisë për të mbuluar nevojat e FSHU-së parashikohen çdo orë dhe përbëhen nga KEK-Gjenerimi, Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) dhe importi, kur prodhimi vendor është i pamjaftueshëm për mbulimin e nevojave të konsumit. Të dhënat e paraqitura në bilancin e energjisë elektrike, duke përfshirë planin e prodhimit nga KEK-u, luajnë një rol vendimtar në përcaktimin e të Hyrave të lejuara maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal.

Në draft bilancin e energjisë elektrike për vitin 2024, KEK gjenerimi ka paraqitur një plan të prodhimit vjetor të energjisë elektrike prej 5,890GWh, i cili shërben si bazë për parashikimin e blerjeve nga importit për konsumin e energjisë elektrike. Marrë parasysh të dhënat historike mbi ndërprerjet e paplanifikuara të njësive gjeneruese të KEK sidomos gjatë sezonit të dimrit, operimi sipas parashikimit në Bilanc është vështirë i realizueshëm. Në këtë kuptim çdo mungesë eventuale nga plani i prodhimit vendor rrit nevojën e zëvendësimit të tij me import. Mbulimi i konsumit të energjisë elektrike nga importi me çmime shumëfish më të larta krijon kostot shtesë për FSHU.

Megjithëse për qëllime të këtij aplikimi ne kemi përdor të dhënat për blerjet e energjisë elektrike konform draft bilancit të energjisë elektrike, është e rëndësishme dhe e domosdoshme që planifikimi të jetë sa më realistik dhe palët ti përmbahen këtyre planeve, pasi që çdo devijim nga plani shkakton implikime në kostot financiare të kompanisë.


Bazuar në parashikimin e konsumit dhe kapaciteteve të disponueshme orë për orë të prodhimit vendor të parashikuar në draft bilancin e energjisë elektrike për vitin 2024, FSHU ka paraparë blerjet e energjisë sipas burimit të prodhimit si në tabelën e mëposhtme:

Bilanci Energjetik 2024	GWh
Blerjet	4,998
<i>KEK Gjenerimi</i>	4,300
<i>Blerjet nga BRE në marrëdhënie kontraktuale me KOSTT</i>	515
<i>Blerjet nga BRE në marrëdhënie kontraktuale me FSHU</i>	43
<i>Importi</i>	140
Konsumi	4,998

3. Kostot e blerjes së energjisë me shumicë

Sipas nenit 17 të Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, kostot e energjisë me shumicë që kanë të bëjnë me shërbimin për konsumatorët e rregulluar përbëhen nga si vijon:

- Kostot e energjisë të blerë nga prodhimi vendor;
- Kostot e importit të energjisë;
- Marzha me pakicë në blerjet e energjisë;
- Kostot neto të jobalancit, të cilave u aplikohet faktori ndarës i jobalancit.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 5 prej 10
		Versioni	1.0

Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë dominohet nga dy termocentrale të mëdha të cilat mbulojnë pjesën më të madhe të kërkesës në vend, ndërsa pjesa e mbetur mbulohet nga Burimet e Ripërtitshme të Energjisë dhe Importi.

Më 29 dhjetor 2023, FSHU ka pranuar shkresë zyrtare nga KEK-Gjenerimi ku propozohet çmimi i blerjeve nga FSHU në 31.50 €/MWh për periudhën 01.04.2024 - 31.03.2025. Sipas shkresës së pranuar, kjo rritje e çmimit vjen si rrjedhojë e rritjes së tarifave të KOSTT përgjatë periudhës 2021-2023 dhe rritjes së inflacionit, e cila ka ndikuar në rritjen e kostos së prodhimit të energjisë elektrike.


Pa paragjykuar arsyeshmërinë e ofertës, me aplikimin e çmimeve të propozuar nga KEK kostot për konsumatorët fundor do të rriten për 6 milion €, apo një rritje prej 2% të MAR. Duke marrë parasysh që nuk kishte kohë të mjaftueshme për të negociuar dhe respektivisht për të arritur një marrëveshje, FSHU në këtë aplikim ka paraparë për blerjet nga KEK çmimin aktual konform Shtojcës 8 të Marrëveshjes së BSA-së. Sidoqoftë, marrë parasysh trendin e lëvizjes së çmimeve në tregjet e energjisë elektrike, FSHU është e gatshme të negocioj me KEK një çmim sipas vlerësimit të ZRRE-së, i cili do të ishte i pranueshme për të gjitha palët e përfshira.

Ndërsa sa i përket BRE-ve në marrëdhënie kontraktuale me Operatorin e Tregut, për shkak të mungesës së informacionit në lidhje me çmimin referent të BRE-ve deri në fazën e aplikimit, në këtë aplikim është shfrytëzuar çmimi aktual referent. Sidoqoftë, duhet të theksohet se çdo ndryshim në çmimin referent gjatë këtij viti tarifor duhet të pasqyrohet nga ZRRE në procesin e llogaritjes së të hyrave të lejuara maksimale të FSHU-së.

Gjatë vitit 2023, FSHU ka pranuar nga ZRRE udhëzim për përditësimin e çmimeve duke aplikuar normën e inflacionit konform marrëveshjeve në fuqi. KESCO ka iniciuar procesin për përditësimin e çmimeve, por meqenëse deri në ditën e aplikimit KESCO nuk ka arritur ende marrëveshje, në këtë aplikim janë përdorur çmimet aktuale.

Parashikimet e FSHU-së për blerjet e energjisë elektrike nga importi sipas draft bilancit të energjisë elektrike për vitin 2024 janë 140 GWh me një çmim mesatar të importit të parashikuar prej 133.40 €/MWh, sipas parashikimeve të fundit në tregjet ndërkombëtare, përfshirë edhe kostot e kapaciteteve të nevojshme për sjelljen e energjisë elektrike në vend.

Vlen të theksohet se në këtë aplikim, FSHU ka përfshirë edhe përshtatjet për jo balanca për vitin 2021. Të dhënat për jo balanca janë në përputhje me faturat e lëshuar nga Operatori i tregut dhe të njëjtat tashmë janë paguar nga FSHU. Këto përshtatje janë aplikuar në përputhje me Rregullën për të hyrat e FSHU, përkatësisht shtojca 3, pika 4.5 përcakton se çdo ndryshim në të hyrat që mund të rezultojë nga llogaritja e gabuar, raportimi i gabuar i të hyrave të realizuara të rregulluara apo kontestimet lidhur me azhurnimet vjetore, do të mbulohen në vitet relevante pasuese. Andaj bazuar në këtë, FSHU kërkon që këto kosto të njihen si kosto të arsyeshme në të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2024.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 6 prej 10
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0

Në përputhje me sa më sipër dhe konform formulës për përcaktimin e Kostove të Blerjes me Shumicë të dhënë në Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, kostot totale për mbulimin e konsumit të parashikuar për vitin 2024 janë vlerësuar si 184.67 milion €.

Përshkrimi	GWh	mil€
KEK Gjenerimi	4,300	126.86
Importi	140	18.68
BRE Prodhimi në marrëveshje kontraktuese me KOSTT	515	28.81
BRE Prodhimi në marrëveshje kontraktuese me FSHU	43	1.93
Përshtatjet për jo balanca		3.81
Margjina me pakicë		4.57
Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë	4,998	184.67

4. Kostot me pakicë


Kostot e lejuara me pakicë përfshijnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, kostot e korporatës, kostot e zhvlerësimit dhe kostot të cilat janë jashtë kontrollit të FSHU-së. Këto kosto njihen nga Rregullatori si të arsyeshme dhe i mundësojnë Furnizuesit operim të duhur.

ZRRE në janar të vitit 2022, përmes vendimit V_1476_2022 ka përcaktuar kostot operative për periudhën 2022-2024 për Furnizuesin me Shërbim Universal. FSHU operon brenda buxhetit të lejuar, duke krijuar efikasitet kurdo që është e mundur në zëra të caktuara në mënyrë që të jetë në gjendje të mbulojë kostot e rritura në zëra tjerë.


Numri i konsumatorëve të furnizuar nga FSHU vazhdon të rritet me rreth 25,000 konsumatorë në baza vjetore, e me këtë edhe rritja e kostove të ofrimit të shërbimeve bëhet më e dukshme. Për më shumë nevojat e kohës në të cilën po jetojmë po kërkon përmirësim të vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve, duke shtuar nevojën për të sjell në përdorim programe të ndryshme teknologjike. Rrjedhimisht, FSHU po përballet me sfidën e balancimit të kostove operative kundrejt domosdoshmërisë për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve.

Rritja e numrit të konsumatorëve po ndikon edhe në rritjen e ngarkesës dhe përgjegjësi brenda vendit të punës. Me liberalizim të vizave që ka filluar në janar të vitit 2024, rreziku i largimit të punonjësve po bëhet gjithnjë e më i dukshëm. Ky largim i mundshëm sjell pasoja për fuqinë punëtore të mbetur, duke çuar në rritje të ngarkesës së punës dhe një dështim të mundshëm për të përmbushur afatet dhe angazhimin në ofrimin e shërbimeve.

Se sa është e rrezikuar Kosova me largimin e punëtorëve e dëshmojnë edhe studimet e ndryshme të realizuara nga institucioneve të ndryshme, siç është Instituti Riinvest, Banka Botërore dhe

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 7 prej 10
		Versioni	1.0

analizat e ndryshme të hartuara nga Odat Ekonomike në Kosovë. Sipas Entit të Statistikave në Kosovë, numri i kosovarëve që kanë emigruar në vende të tjera, ka ndjekur një trend rritjeje gjatë viteve të fundit – përveç në vitin 2020, kur udhëtimet janë kufizuar shkaku i pandemisë COVID-19.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës


Sipas të dhënave nga Komisioni Evropian për shtetet e rajonit, pas liberalizimit të vizave është vërejtur një trend i zvogëlimit të rasteve të kalimit ilegal të kufijve, mirëpo, në të njëjtën kohë, është rritur numri i rasteve të vizitorëve që tejkalonin kohëzgjatjen e lejuar të qëndrimit në zonën Schengen – deri në 90 ditë brenda gjashtë muajve.

Analizat e Institutit Riinvest tregojnë se mbi 30% e punëtorëve pritet të largohen. Largimi i përhershëm ose i përkohshëm i punëtorëve do të destabilizoj tregun e punës në Kosovë. Sipas anketave të realizuara me fuqinë punëtore arsyet kryesore për migrim janë pagat dhe kushtet më të mira të punës. Sipas Institutit Riinvest mbi 70% e bizneseve të anketuara kanë ndërmarrë hapa për të frenuar trendin e largimit të punëtorëve, duke rritur mesatarisht mbi 20% të pagave të punëtorëve dhe se edhe gjatë vitit 2024 priten rritje tjera të pagave.

Në një skenarë të tillë, ku punëtorët e FSHU-së mund të largohen qoftë edhe përkohësisht, duke shfrytëzuar të drejtën e qëndrimit në zonën Schengen deri në 90 ditë, FSHU mund të përballlet me sfida të qëndrueshmërisë dhe joefikasitetit operativ. Për më tepër, FSHU vazhdimisht ka qenë nën presion nga punonjësit që kërkojnë rritje të pagave dhe mos-reflektim i kërkesave të tyre do të ndikoj në kualitetin e shërbimeve të ofruara dhe jo vetëm.

Marr parasysh si më lartë, FSHU në këtë aplikim parashikon një rritje të pagave për punëtorët prej 15%, me qëllim që të pasqyrohet vlera e tyre për kompaninë dhe nivelizimin e tyre me pagat e të licencuarve të tjerë të sektorit.

Për më tepër, në përputhje me Rregullën për të Hyrat, FSHU do të përshtat inflacionin për kostot e miratuara të vitit 2023, si për OPEX ashtu edhe për kostot e zhvlerësimit.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 8 prej 10
		Versioni	1.0

5. Kostot e bartshme

Konform nenit 18 të Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, gjatë përcaktimit të MAR-it, FSHU do të mbulojë kostot e mëposhtme:

- Kostot e OT që faturohen nga OT dhe kanë të bëjnë me Konsumatorët e FSHU-së;
- Kostot e OS të cilat faturohen nga OS dhe ndërlidhen me Konsumatorët e FSHU-së;
- Kostot e SHST (TUOS) që faturohen nga OST dhe ndërlidhen me Konsumatorët e FSHU-së;
- Kostot për përdorimin e sistemit të shpërndarjes që faturohen nga OSSH dhe lidhen me Konsumatorët e FSHU-së.


Për më tepër, përveç kostove të sipërpërmendura OT faturon FSHU-në edhe për fondin BRE, i cili do të përfshihet si pjesë e kostove të bartshme.

Zhvillimet e reja gjatë vitit 2024, të tilla si fillimi i operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) dhe fillimi i operimit të OSSH-se në pjesën veriore të Kosovës do të ndikojnë në kostot operative të OST-se dhe OSSH-së, dhe rrjedhimisht në kostot e bartshme për FSHU-në.

Marrë parasysh si më lartë dhe trendin e rritjes së kostove tek licencuarit e tjerë dhe meqenëse nuk ka dallime në afatet kohore kur të licencuarit e tjerë paraqesin aplikimet e tyre, FSHU në kërkesën për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2024 do të aplikoj një rritje prej 5% për kostot e bartshme. Sidoqoftë, çfarëdo ndryshimi nga ZRRE-ja gjatë përcaktimit të tarifave për OSSH dhe OST duhet të pasqyrohet në MAR-in përfundimtar për Furnizuesin me Shërbim Universal.

Fillimi i operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) do të rezultojnë me kosto shtesë edhe për FSHU-në. ZRRE përmes vendimit nr.V_1766_2023, ka aprovuar tarifën për periudhën tranzitore të Bursës shqiptare të energjisë elektrike ALPEX për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës, andaj në këtë aplikim FSHU ka paraqitur kostot e parapara sipas këtij vendimi.

Konform Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, në këtë aplikim janë përshtatur edhe kostot e bartshme për vitin 2023. Përveç tyre, FSHU ka aplikuar edhe përshtatjet e kostove të bartshme për vitin 2021, marr parasysh që të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2021 janë aprovuar si rrjedhojë e shqyrtimeve të jashtëzakonshme dhe të dhënat për muajin dhjetor 2021 ishin preliminare.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 9 prej 10
		Versioni	1.0

6. Përshtatjet dhe Faktori korrigjues i të hyrave

Gjatë çdo viti tarifor Furnizuesi parashikon kostot e tij të cilat aprovohen nga ZRRE. Megjithatë, gjatë vitit aktual ekzistojnë dallime në mes të kostove të lejuara dhe aktuale, prandaj përmes një faktori korrigjues këto kosto përshtaten duke reflektuar diferencën ndërmjet kostove të lejuara dhe atyre aktuale.

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së është bërë korrigjimi i të hyrave të vitit 2023 dhe faktori korrigjues ka rezultuar të jetë 25.66 milion €, siç është paraqitur në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	mil €
MAR-i i Aprovuar	398.44
MAR-i Aktual	413.28
Shitjet aktuale	389.28
It	6.91%
Faktori korrigjues i të hyrave (ADJt)	25.66


Duhet theksuar se ndryshimet më të mëdha në MAR-in aktual të vitit 2023 nga ai i aprovuar është për shkak të vlerës më të lartë për 17 milion € në koston e importit si dhe ndryshimit të të hyrave nga shitjet e energjisë elektrike tek konsumatori fundor me atë të parashikuar gjatë përcaktimit të MAR-it për vitin 2023.

Reflektimi i saktë i kostove mundëson operim të qëndrueshëm dhe efikas. Për të tretin vit radhazi, duke filluar që nga viti 2020, FSHU operon me pambulueshmëri të kostove si rrjedhojë e pandemisë COVID-19 dhe krizës energjetike, e cila ka reflektuar me KREV pozitiv, barrë financiare kjo e bartur nga i licencuari. Prandaj aplikimi drejtë i kostove i mundëson Furnizuesit operim të qëndrueshëm por njëkohësisht edhe kosto më e ultë për konsumatorin fundor, i cili paguan interes shtesë për çdo kosto të tejkalluar gjatë vitit aktual.

7. Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2024

Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për vitin 2024 do të mbulohen nga tarifat e rregulluara të shitjes me pakicë dhe përfshijnë vetëm kostot e konsumatorëve që do të furnizohen nga Furnizuesi me Shërbim Universal.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të kërkesës për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU-në për vitin 2024, pasi të dihen të gjitha elementet e kostove, siç është shpjeguar në kapitujt e mëparshëm dhe konform formulës për llogaritjen e Të Hyrave të Lejuara Maksimale në vitin relevant t:

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 10 prej 10
		Versioni	1.0

$$MAR_t = (RETR_t + WCLC_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t + KREV_t) / (1 - BDTA_t)$$

Të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2024		mil€
It		6.91%
Kostot me pakicë		5.89
<i>OPMC_t</i>		5.76
<i>DEPC_t</i>		0.13
Kostot e bartshme (PSTC _t)		183.55
Kostot e OST		24.47
Kostot e OSSH		142.57
Fondi BRE		16.51
Kostot e kapitalit punues (WCLC _t)		2.15
Kostot e energjisë me shumicë (WHPC)		184.67
WHPC		180.10
Margjina me pakicë		4.57
Faktori i përshtatjeve të të hyrave (ADJ)		25.66
BDTA		8.20
MAR		410.15

Përcaktuesit e faturimit për vitin 2024 janë bazuar në vëllimet e shitjeve të parashikuara në draft bilancin e energjisë elektrike për vitin 2024. Me aplikimin e tarifave aktuale mbi përcaktuesit e faturimit të parashikuar për vitin 2024, priten të hyra të faturuara në vlerë prej 397.47 milion €, përderisa kostot e nevojshme për operim të duhur të FSHU-së për vitin 2024 janë 410 milion €.

Përgjatë viteve është dëshmuar se tendenca për të siguruar tarifa të përballeshme të energjisë elektrike është e arsyeshëm, duke mbajtur kostot e operimeve në nivelin e pritshëm. Sidoqoftë, zhvillimet e viteve të fundit kanë dëshmuar se është thelbësore të arrihet një ekuilibër midis përballeshmërisë afatshkurtër dhe qëndrueshmërisë afatgjatë. Ulja e vazhdueshme e kostove të parashikuara ka efekte të dëmshme në investimet në infrastrukturë, inovacion, stabilitetin financiar dhe elasticitetin e përgjithshëm të sektorit të energjisë. Prandaj, është e nevojshme një qasje më holistike dhe më gjithëpërfshirëse për të siguruar një të ardhme energjie të besueshme, efikase dhe të ndërgjegjshme për mjedisin për të gjithë konsumatorët.

FSHU mbetet i angazhuar për bashkëpunim me qëllim të arritjes së konkluzioneve të duhura, të cilat janë në interesin e të gjitha palëve të përfshira në sektorin e energjisë.